



Fakulteti i Shkencave Sociale

Nr. 1223 Prot.

Tiranë më, 14.12.2021

Bashkia Tiranë

Nr. 52105 Prot.  
Tiranë më, 31.12.2021

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE

dhe

BASHKISË TIRANË

PËR

PRAKTIKËN MËSIMORE DHE PROFESIONALE

Sot, më datë 31.12.2021 lidhet ky memorandum bashkëpunimi midis palëve:

1. Bashkisë Tiranë, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1, 10001, Tiranë, Përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj, quajtur këtu e në vijim si "Bashkia";  
dhe
2. Fakultetit të Shkencave Sociale, me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Edmond Rapti, quajtur këtu e në vijim si "Fakulteti";

Të quajtura bashkarisht ose veçmas si "Palët".

Duke qenë se:

Palët kanë shprehur vullnetin për ngritjen e urave të bashkëpunimit midis tyre për mundësimin e angazhimcve të përbashkëta në studime, trajnime, seminare, konferenca, procese të vlerësimit të shërbimeve, standardeve dhe kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve, praktikave mësimore, si dhe në hartimin e politikave të reja sociale, programeve dhc projekteve të shërbimeve për grupe dhe komunitete në nevojë, palët bien dakort të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me kushte si më poshtë vijon:

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij memorandumi është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit dhe njohja e ndërsjelltë, ngritja dhc zhvillimi i mëtejshëm i njohurive profesionale dhe akademike, ngritja e kapaciteteve të stafit dhe studentëve si dhc shkëmbimi i praktikave më të mira në fushat me interes të përbashkët midis palëve.

## **Neni 2 Objekti**

1. Objekti i këtij memorandumi është bashkëpunimi midis palëve në lidhje me kryerjen e praktikave mësimore pranë Bashkisë Tiranë për studentët e Fakultetit.
2. Memorandumi synon bashkëpunimin midis palëve në drejtim të shkëmbimit të ekspericencave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

## **Neni 3 Baza ligjore**

Ky memorandum bazohet në:

- a) ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);
- b) ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- c) ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- ç) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar);
- d) rregulloren "Mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë" miratuar me Vendimin numër 32575 datë 16.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë.

## **Neni 4 Angazhimet e palëve**

1. Palët marri përsipër të bashkëpunojnë bazuar në fryshtë e një mirëkuptimi reciprok dhc vullneti pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshtme për realizimin e angazhimit dhe iniciativave të ndërmarrja nga palët.
2. Fakulteti merr përsipër të udhëzojë studentët e angazhuar në studime pranë Fakultetit mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë.
3. Bashkia merr përsipër të zbatojë procedurat e parashikuara nga rregullorja "Mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë" për ofrimin e praktikave mësimore për studentët e Fakultetit.
4. Në lidhje me përbledhjen, përpunimin apo transferimin e të dhënave personale gjatë zbatimit të angazhimeve të parashikuara nga ky memorandum, palët amrrin përsipër të përbushin të gjitha detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **Neni 5 Personi i kontaktit**

1. Personat e kontaktit do të janë përgjegjës për zbatimin e këtij memorandumi, me qëllim realizimin e objektivave duke komunikuar dhe shkëmbyer të dhënat në mënyrë sa më korakte dhe efektive.

2. Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumi janë:

Për Bashkinë Tiranë:

Z./Znj. (emër mbiemër) *Romina Zaimi*  
Email: *romina.zaimi@tirana.al*  
Tel: \_\_\_\_\_

Për Fakultetin:

Dr. Blerina Hamzallari  
Email: *blerina.hamzallari@unitir.edu.al*  
Tel: \_\_\_\_\_

3. Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjeter nënshkruese brenda një javë kalendarikë për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

**Neni 6  
Afati**

1. Ky memorandum lidhet për një afat 2 (dy) vjeçar.
2. Afati fillon nga data e nënshkrimit të këtij Memorandumi nga të dy palët.
3. Çdonjëra nga palët mund të kërkojë të zgjidhë memorandumin duke lajmëruar palën tjeter me shkrim të paktën një muaj përpara datës së zgjidhjes.

**Neni 7  
Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në fryshtë e bashkëpunimit, tolerancës dhe kuadrit të etikës morale.

**Neni 8  
Dispozita kalimtare**


1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë memorandum bashkëpunimi për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6.
2. Memorandumi mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një marrëveshje me shkrim të nënshkuar nga të dyja palët
3. Ky memorandum përpilohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat 2 (dy) mbahen nga Bashkia dhe 2 (dy) mbahen nga Fakulteti.
3. Kushtet e këtij Memorandumi Bashkëpunimi pranohen dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

**Palët nënshkruesc**

Për Fakultetin

Prof. Dr. Edmond Rapti

Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale



Për Bashkinë Tiranë

Z. Erion Veliaj

Kryetari i Bashkisë Tiranë

